


Dok.	TIA-REG-001	Rregullore mbi ndalimin e konsumit të duhanit	
Rev.	02		
Datë	01/07/2024		Internal/External

RREGULLORE
Mbi ndalimin e konsumit të duhanit në mjediset e Tirana International Airport “Nene Tereza”

Në zbatim të Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004 PER RATIFIKIMIN E MARREVESHJES SE KONCESIONIT, NDERMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE SHOQERISE KONCESIONARE "TIRANA AIRPORT PARTNERS", SHPK, PER NDERTIMIN, VENIEN NE PUNE, OPERIMIN DHE MIREMBAJTJEN E AEROPORTIT NDERKOMBETAR "NENE TEREZA", TIRANE DHE PER DHENIEN E DISA STIMUJVE KESAJ SHOQERIE KONCESIONARE si dhe te detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 9636, date 06.11.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit” (i ndryshuar) me Ligjin Nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006”, duke qene se “Tirana International Airport” SHPK (quajtur me pare “*Tirana Airport Partners*”), eshte subjekti qe menaxhon Tirana International Airport “Nene Tereza” si dhe te gjitha ambjentet brenda zones se koncensionit, pervec kur keto ambjente jane kontraktuar tek persona te trete per menaxhim dhe operim, keto persona do te jene pergjegjes, në kuadrin e parandalimit të pasojave të dëmshme që sjell duhani në shëndetin e njeriut, miratohet kjo rregullore e cila,

VENDOS:
Neni 1.

Ndalohet konsumi i duhanit ne te gjithë ambjentet e mbyllura brenda zones se koncensionit Tirana Internationa Airport, por pa u kufizuar, si:

- a) Terminali dhe Kargo;
- b) Godina e Administrates;
- b) Dyqanet;
- c) Magazinat;
- d) Lokalet;
- e) Mjedise e perbashketa te mbyllura te qarkullimit
- f) Godina e Sherbimit te Zjarrefikseve;
- g) Zyrat;
- h) Korridoret;
- i) Tualetet;
- j) Mjediset e perbashketa të qarkullimit brenda godinës.

Shenja lehtesisht te dallueshme me paralajmerimin “NDALOHET DUHANI” do te vendosen te gjitha vendet e listuara me siper. Departamenti i Menaxhimit te Aseteve dhe Mjedisit do te jete pergjegjes per permbushjen e ketij detyrimi. Per shmangie te cdo dyshimi, edhe ne ato ambjente te mbyllura ku shenjat paralajmeruese mungojne, pirja e duhanit do te jete e ndaluar.

Neni 2

Në faqen zyrtare të TIA do të publikohet në vend të dukshëm, një mesazh informues mbi kufizimet e konsumimit te duhanit ne Tirana International Airport “Nene Tereza”. Për përmbushjen e këtij detyrimi ngarkohet Departamenti i IT dhe i Komunikimeve.

Dok.	TIA-REG-001	Rregullore mbi ndalimin e konsumit të duhanit	
Rev.	02		
Datë	01/07/2024		Internal/External

Neni 3

3.1 Cdo pasagjere dhe/ose cdo person tjetër që do të identifikohet duke konsumuar duhan në vendet e përcaktuara sipas nenit 1, do të mbajë përgjegjësi drejtperdrejt dhe do të ndërmerren masa në zbatim të nenit 20/ë të Ligjit Nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit", i ndryshuar, deri në sanksione me gjobe nëse konsumon duhan në zonat e ndaluara.

3.2 Për të gjithë punonjësit, të cilët do të identifikohen duke konsumuar duhan në vendet e përcaktuara sipas nenit 1, do të ndërmerren masa në zbatim të nenit 20/ë të Ligjit Nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit", i ndryshuar, ku janë të përcaktuara sanksionet me gjobë dhe do të ndërmerren masa disiplinore për personat që janë në shkelje të kësaj rregullore.

3.3 Në të gjitha kontratat e lidhur ndërmjet TIA dhe nënkontratoreve si dhe subjekteve qiramarrëse është përcaktuar qarte në ambjentet e mbyllura të dhëna për shfrytëzim tek këto pale ESHTE E NDALUAR PIRJA E DUHANIT. Nënkontraktoret e TIA, subjektet qiramarrëse të ambjenteve të mbyllura të përfshira brenda zonës së koncensionit, si dhe cdo subjekt tjetër, pa përjashtuar administratorët dhe/ose personat përgjegjës të caktuar nga subjektet e lartpërmendura, që ushtrojnë aktivitet në ambjentet ku ndalohet pirja e duhanit, do të marrin të gjitha masat në zbatim të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 (të ndryshuar), në rast të kundërt, këto subjekte, administrator ose personi i caktuar prej tyre si përgjegjës për menaxhimin e aktivitetit do të mbajnë përgjegjësi drejtperdrejt për shkelje të konstatuara si dhe do të përgjigjen ndaj cdo lloji sanksioni të vendosur nga inspektoriatit përkatës i caktuar për zbatimin e Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006.

3.4 Nënkontraktoret e TIA, subjektet qiramarrëse të ambjenteve të mbyllura të përfshira brenda zonës së koncensionit, si dhe cdo subjekt tjetër, administrator e këtyre subjekteve dhe personat përgjegjës të caktuar prej tyre, që ushtrojnë aktivitet në ambjentet ku ndalohet pirja e duhanit do të mbajnë përgjegjësi sipas parashikimeve të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 (i ndryshuar) për rastet kur punonjësit e tyre, konsumojnë duhan në mjediset e përbashkëta të mbyllura, në tualetet si dhe në cdo mjedis tjetër të mbyllur që ka të njëjtin qëllim në Terminal, në Zonën e Kargos, në Godinën e Administratës, përfshirë këtu cdo hapësirë tjetër të mbyllur, brenda zonës së koncensionit, ku është e ndaluar pirja e duhanit.

3.5 Nënkontraktoret e TIA, subjektet qiramarrëse të ambjenteve të mbyllura të përfshira brenda në zonën e koncensionit, si dhe cdo subjekt tjetër që ushtrojnë aktivitet në ambjentet ku ndalohet pirja e duhanit, kanë detyrimin të caktojnë një person përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore në zbatim të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 (të ndryshuar)

Neni 4

4.1 Me qëllim zbatimit rigoroz të ligjit antiduhan dhe kësaj rregullore, detyrohen të gjithë punonjësit që identifikojnë persona të cilët konsumojnë duhanin brenda zonës së koncensionit, të lajmërojnë personin përgjegjës në mënyrë që të merren masa të nevojshme.

4.2 Të gjithë Punonjësit e TIA kanë detyrimin të respektojnë parashikimet e kësaj rregullore si dhe të dispozitave të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 (të ndryshuar). Për punonjësit që konsumojnë duhan në zonat e ndaluara, do të merren masa disiplinore deri dhe duke përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës, në përputhje me Nenin 153 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Dok.	TIA-REG-001	Rregullore mbi ndalimin e konsumit të duhanit	
Rev.	02		
Datë	01/07/2024		Internal/External

4.3 Nje kopje e kesaj rregullore do te vihete ne dispozicion te cdo punonjese te punesuar nga TIA.

Neni 5

- 5.1 Personat përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore për TIA, janë si më poshtë:
- Për zyrat e TIAs do të jetë Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerezore (HRD);
 - Për Terminalin e Pasagjereve do të jetë Menaxheri për Eksperiencën e Pasagjerit (CX);
 - Për Zonën Ajrore do të jetë Menaxheri i Operimeve në Detyrë (ODM).
- 5.2 Personat e lartpërmendur kanë të drejtë të paralajmërojnë cdo individ që konstaton duke përdorur duhan në zonat ku ndalohet konsumi i duhanit duke e urdhëruar të fike duhanin, në rast të kundërt do të njoftojë forcat e rendit. Gjithashtu, personi përgjegjës ka të drejtë të denoncojë ose raportojë cdo rast duke vizuar website <http://www.shqiperiajoduhani.al/> ose duke telefonuar numrin **08004040**.
- 5.3 Në rastin kur konstatohen punonjës të punësuar nga TIA duke konsumuar duhan në zonat e ndaluara, personi përgjegjës ka të drejtë të lajmërojë direkt Departamentin e Burimeve Njerezore të TIA-s, e cila, në bashkëpunim edhe me drejtuesit e TIA-s, do të marrë masa disiplinore ndaj punonjësit ose punonjëseve të TIA-s deri dhe duke përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës, në përputhje me Nenin 153 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.
- 5.4 Personi përgjegjës do të informojë Departamentin e Menaxhimit të Aseteve dhe Mjedisit për të vendosur shenja paralajmëruese në ato vende ku sipas Ligjit nr. 9636, datë 06/11/2005 duhani është i ndaluar por shenja paralajmëruese mungon.
- 5.5 Referuar Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 (të ndryshuar), në rast shkelje të dispozitave ligjore dhe të kësaj rregullore, subjektet e tatueshme, administratori apo personat përgjegjës, si dhe punonjësit duhanpires, do të denohen me gjobe nga autoriteti përkatës në përputhje me nenin 20 të ligjit të lartpërmendur.

Neni 6

- 6.1 Kjo rregullore i behet e njohur te gjitha punonjesve te TIAs, nenkontraktoreve, subjekteve qiramarrese te saj si dhe cdo cubjekti tjeter qe ushtron aktivitet prane zones se Konkensionit.
- 6.2 Nje kopje e firmosur e kesaj rregullore do te publikohet ne faqen zyrtare te internetit te TIA-s.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Marsida Pallko
Administratore e TIA-s

Piervittorio Farabbi
Menaxher Përgjegjës i TIA-s dhe
Administrator / COO

